



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr. 848/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtësen Valdete Sadiku, në çështjen penale ndaj të pandehurit R.J nga Mitrovica për veprën penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm PP.nr. 3423/2018, dt.11.10.2018, akuzën e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Stojanka Kasallovic, ndërsa pas mbajtjes së seancës se shqyrtimit fillestar, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366 të KPP-së, me dt.27.03.2019 është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.29.03.2019.

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R.J., me nofken “...” nga i ati B., e ëma Xh. e gjinise O., i lindur me dt. ... në ..., në lagjen e ... në rr “...” nr. ... ku edhe tani jeton, rom, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, nën masën e paraburgimit dhe arrest shtëpiak që nga dt.05.09.2018 gjerë me dt. 05.10.2018.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE; me dt. 05.09.2018 rreth orës 09:45 min në ... në rrugën e “...” saktësishtë në dyqanin -podrumin e pijeve ku shitën pijet alkoolike dhe lëngje, miell, vaj, sheqër, e gjëra të tjera ushqimore - pronë e të dëmtuarit Zh.B. nga ..., i pandehuri me qëllim që vetit ti sjell pasuri të kundërligjshme ka marrë pasurinë e huaj të luajtshme ashtu që ka shkuar në këtë dyqan ka hyrë brenda pasi që dera ishte e hapur ka parë se aty nuk ishte askush derisa pronari i dyqanit kishte shkuar në tualet për ti pastruar duart pas pastrimit të dyqanit, atëherë i dyshuari ka vrejtur në vitrinë të dritares të dyqanit nga ana e brendshme çantën e meshkujve me ngjyrë të zezë të mbuluar me gazetë dhe menjëherë e ka marrë të një jtën dhe si ka dal nga dyqani çantën e futë nën trenerk dhe largohet në drejtim të panjohur, ku sipas të dëmtuarit në çantë kishte pasur rreth 2000 euro (dymijë euro) para të gatshme dhe një kuletë me dokumente personale, e që pas punës operative të Policis pas dite tek i pandehuri në banesën e tij gjenden parat në shumë prej:1,310euro dhe 18.980 dinar (rreth 160euro), të cilat i kthehen të dëmtuarit së bashku me dokumentet personale, ndërsa rreth 260 euro i kishte harxhuar i akuzuari gjatë ditës duke blerë trenerka rreth 15euro, patike 25 euro, jakne 20 euro, një telefon 100 euro dhe 100 euro i kishte hargjuar me shokë në restorant.

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykatat në baze të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 50, 51, 52, 73 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së i;

S H Q I P T O N

DËNIMIN ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit nuk kryen vepër penale, nëse akuzuari kryen vepër penale në këtë dënim do të llogaritet koha e kaluar nën masën e paraburgimit respektivisht arrestit shtëpiak që nga dt.05.09.2018 deri me dt.05.10.2018, si dhe DËNIM me GJOBË në shumë prej 200€(dyqindeuro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit nuk kryen vepër penale.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarit Zh.B, ti kompensoj dëmin material në shumë prej 260€, në afat prej 30 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat të përmbartimit të dhunshëm, për pjesën tjetër të dëmit i dëmtuari udhëzohet në kontestin civilo-juridik.

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 20€, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20€ si dhe 30 € në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i përgjithshëm pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.3423/2018 dt.11.10.2018, ndaj të pandehurit R.J nga Mitrovica për veprën penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka prezantuar Prokurori i Shtetit Stojanak Kasalloviq, i pandehuri R.J, ku është vazhduar me mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij konform nenit 246 par.1 të KPP-së, pas deklarimeve të të pandehurit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e kupton aktakuzën dhe pas bindjes së gjyqtarit se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, i është ofruar mundësia që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm, ku i pandehuri është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat e pranimit të fajësisë se vepra penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, përcakton se kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri 3 vite, në rast të pranimit të fajësisë gjyqtari i çështjes e njofton se nuk e ka të drejtën në parashtrimin e ankesës nga baza e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike të përcaktuar me nenin 383 par. 2 të KPP-së, po ashtu e njofton se nuk do të procedohet me prova materiale ndërsa pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata do ta vlerësoi si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit.

I pandehuri ka deklaruar se i kupton pasojat e pranimit të fajësisë dhe rrethanat lehtësuese që i merr gjykata me rastin e matjes së dënimit dhe i pandehuri qëndron pranë pranimit të fajësisë.

Në mbështetje të nenit 248 par.2 të KPP-së është kërkuar mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit e cila ka deklaruar se gjykata ta aprovoj pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm është mbështetur në provat materiale dhe gjykata të aprovoj një pranim të tillë.

Pas kësaj gjyqtari është i bindur se i pandehuri e kupton natyrën e pranimit dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj Gjyqtari në procesverbal në kuptim të nenit 248 par.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që Gjykata ka pranuar pranim të fajësisë për të pandehurin, i pandehuri ka deklaruar se më vjen keq për këtë veprim, kam qenë në paraburgim, po ashtu edhe në arrest shtëpiak, që nga ajo kohë nuk kam kryer vepra tjera, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, jam i gjendjes së dobët ekonomike dhe jam i pa punë kërkoj që të më caktoj një dënim me të lehtë.

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i pandehuri në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 361 të KPP-së, gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova materiale se në veprimet e të pandehurit kemi të bëjmë me elementet e veprës penale me të cilën akuzohet, kjo konstatohet deklarata e dhënë nga i dëmtuari Zh.B, deklarata e të pandehurit

dt.11.10.2018, vërtetimi mbi listën e gjërave të konfiskuara nga i pandehuri R.J., dt.05.09.2018, dt.06./09.2018, CD, fotodokumentaoni nga shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen – krijohen elementet e veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, të gjitha rrethanat si me lart tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Duke vlerësuar përgjegjësinë penale të të pandehurit në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të pandehurit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin me përjashtuar përgjegjësin penale të të akuzuarit në këtë çështje penale.

Shpallja e aktgjykimit është bërë po të njëjtën ditë në mënyrë publike në prezencë të të pandehurit dhe Prokurorit të Shtetit.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartsisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, gjykata me rastin e matjes së dënimit si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtim e tij se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, shprehjen e keqardhjes, i moshës së re në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoj mënyrën dhe rrethanat se si ka kryer veprën penale, në shkaktimin e dëmit dhe shqetësimit tek pala e dëmtuar, Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri, dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i parapare me nenin 41 të KPRK-së, se i pandehuri në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e ka marrë konform neneve 450 dhe 451 të KPP-së, demi material për të dëmtuarin është aprovuar pjesërisht dhe atë në shumë prej 260€, ndërsa për kërkesën tjetër eventuale si të demit material apo edhe jo material pala e dëmtuar është udhëzuar në kontestin civilo-juridik në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPP-së, për të cilën gjykata ka vlerësuar se do të jetë vendimi më i arsyeshëm.

Nga theksimet e theksuara si me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.848/2018, dt.29.03.2019

Procesmbajtësja
Valdete Sadiku

Gjyqtari
Bekim Veliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykatë, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.